



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

Programi i Trajnimit, për Testimin Fillestar dhe Periodik të Inspektorit të Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial



Tiranë 2021

Tabela përmbledhëse

| | |
|--|----|
| INSPEKTORATI SHETETËROR TEKNIK INDUSTRIAL..... | 3 |
| Qëllimi..... | 3 |
| Rezultatet..... | 3 |
| Metodologjia | 3 |
| Organizimi dhe funksionimi i ISHTI-it..... | 4 |
| Objektivat | 4 |
| Funksionet | 4 |
| Inspektimi i naftës dhe gazit..... | 5 |
| Moduli 1..... | 5 |
| 1. Inspektimi i naftës | 8 |
| Moduli 2..... | 15 |
| 2. Inspektimi i gazit..... | 17 |
| Moduli 3..... | 19 |
| 3. Inspektimi i pajisjeve nën presion | 19 |
| Moduli 4..... | 20 |

INSPEKTORATI SHETËROR TEKNIK INDUSTRIAL

- ✓ VKM nr. 410, datë 13.05.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”;
- ✓ Rregullorja e Brendshme, miratuar me Urdhrin nr. 900, datë 21.12.2010, të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ushtron inspektime në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe gazit dhe nënprodukteve të tyre, e garantimit të sigurisë së njerëzve dhe vlerave materiale nga rreziqet e shfryrjeve dhe të shpërthimeve të shkaktuara nga pajisjet nën presion, si dhe nga pajisjet dhe instalimet elektrike, si dhe ushtron funksionin e tij rregullator në përputhje me nevojat e vendit, të mbrojtjes kombëtare dhe të sigurimit publik, duke respektuar parimet e ekonomisë së tregut.

Qëllimi

Qëllimi i këtij moduli është aftësimi profesional i inspektorëve, si dhe përfitimi dhe përditësimi i njohurive shtesë sipas funksioneve në fushën e inspektimit të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, duke përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë inspektuese.

Rezultatet

Synohet efektivitet në veprimtarinë inspektuese dhe rritje të standardeve të punë. Efektivitet në garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve e instalimeve nën presion, në garantimin e cilësisë së naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, si dhe në garantimin e sigurisë së njerëzve, kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale nga rreziku.

Metodologjia

Leksion teorik i legjislacionit sektorial.

Trajtimi i rasteve praktike.

Sesione teorike të veçanta do të shoqërohen edhe me sesione praktike, duke ushtruar një procedurë inspektuese (tip) të fushës së veprimtarisë së ISHTI-t.

Kohëzgjatja e modulit: 30 orë (5 ditë)

Organizimi dhe funksionimi i ISHTI-it

Objektivat

- ✓ Qëllimi i krijimit të ISHTI-t.
- ✓ Mënyra e organizimit.
- ✓ Funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë.
- ✓ Rregullat lidhur me organizimin dhe funksionimin e ISHTI-t.

Struktura përgjegjëse për inspektimin mbi zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e : përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas legjislacionit përkatës; sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike, sipas legjislacionit përkatës; sigurisë së punës së instalimeve nën presion; sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror; sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë joushqimore, sipas legjislacionit përkatës; çdo përgjegjësi tjetër të përcaktuar me ligj/akt nënligjor.

Funksionet

- ✓ Planifikon, bashkërendon dhe realizon veprimtarinë e inspektimit;
- ✓ Siguron unifikimin e praktikave të inspektimit, në shkallë vendi;
- ✓ Bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve të saj dhe, në rast pamundësie teknike siguron kryerjen e analizave nga laboratorë të tjerë të akredituar;
- ✓ Informon publikun për veprimtarinë e inspektimit;
- ✓ Jep mbështetje teknike, administrative dhe shkencore për veprimtarinë e inspektimit;
- ✓ Përgatit programin e raportin vjetor të inspektimit dhe raportin mbi rastet e veçanta të inspektimit të kryera jashtë programit;
- ✓ Kryen, sipas programit vjetor të miratuar paraprakisht prej ministrisë, inspektime të drejtpërdrejta në gjithë territorin e vendit në një apo disa fusha të caktuara inspektimi, si dhe inspektime të drejtpërdrejta të paplanifikuara për raste të veçanta, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, ndaj subjekteve që kryejnë veprimtari me rrezik të lartë;
- ✓ Kryen funksionet e shërbimeve të brendshme mbështetëse, të menaxhimit financiar dhe të auditimit të brendshëm; f) Kryen çdo funksion tjetër, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Mënyra e organizimit – nivel qendror / Drejtoritë me funksione inspektimi:

DING – Drejtoria e Inspektimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre

DIPNP – Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion

DIPIE – Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike dhe makinerive ngritëse

Inspektimi i naftës dhe gazit

Moduli I

- ✓ Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për Përpunimin, Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar
- ✓ VKM nr.970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar;
- ✓ VKM nr.755, datë 12.11.2014, “Për përcaktimin e procedurave e të kushteve për dhënien e “licencës së përpunimit” për impiantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës”;
- ✓ VKM nr.19, datë 14.01.2015, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj”, i ndryshuar;
- ✓ VKM nr.411, datë 13.05.2015, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e përsëritjen e licencës”.

Struktura përgjegjëse e inspektimit

Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe nënprodukteve të tyre

Misioni dhe funksionet:

- a) Planifikimi, drejtimi dhe inspektimi për zbatimin e politikave dhe strategjive shtetërore për respektimin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë për shpërndarjen e komercializimin e karburanteve, duke propozuar dhe promovuar politika, për zbatimin e praktikave më të mira.
- b) Monitorimi i përputhshmërisë me standardet teknike e sigurisë të rafinerive të naftës dhe impianteve të përpunimit, shoqëritë e transportit të tregtimit me shumicë dhe pakicë të karburanteve, duke kryer vlerësimin e raporteve të inspektimit dhe masat e marra për sigurimin e punës pa rrezik, në përputhje me dispozitat ligjore.
- c) Zbatimin e kushteve të përcaktuara në lejet apo autorizimet përkatëse, që u janë dhënë personave juridikë, që ato të respektojnë normat teknike për mbrojtjen ndaj zjarrit dhe ruajtjen e mjedisit, ne terminallet detare, depozitat bregdetare dhe territorin e brendshëm.

- d) Respektimin e treguesve cilësorë të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, për parandalimin e abuzimeve dhe të falsifikimeve, nëpërmjet marrjes së mostrave të produkteve të naftës dhe të gazit, që importohen, prodhohen në vend dhe tregtohen në tregun e brendshëm, si edhe të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport dhe sjelljen e tyre për analizë në Laboratorin Qendror të Kontrollit të ISHTI-t. DINGN, si pjesë e ISHTI-t, në varësi të MIE, synon që t'u garantojë qytetarëve një furnizim të qëndrueshëm, të sigurt, të besueshëm, me efikasitet dhe cilësi, të mbështetur nga mekanizma efektivë të kontrollit, teknologjisë së lartë dhe burimeve njerëzore të kualifikuara.
- e) Detyra e inspektimit dhe mbikëqyrjes është të garantojë sigurinë e produkteve të prodhuara, importuara dhe të shitura, nga subjekti i inspektuar, sigurinë e proceseve teknologjike për jetën e shëndetin e njerëzve, mbrojtjen e pronës së tyre, sigurinë e mjedisit, sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë, përfshirë sigurinë ekonomike, parandalimin e praktikave mashtruese, mbrojtjen e natyrës dhe burimeve të energjisë, duke rritur konkurrencën e produkteve kombëtare.

Inspektimi si proces

Inspektori:

- ✓ zbaton programin mujor me tematikë;
- ✓ përcakton qëllimin, llojin e inspektimit (edhe për rastet kur është i paprogramuar);
- ✓ ndjek të gjitha hapat e procesit sipas akteve ligjore në fuqi;
- ✓ merr informacion për historikun e subjektit;
- ✓ kryen njoftimin paraprak (kur nuk ka përjashtime ligjore);
- ✓ paraqitet në subjekt konform rregullave të përcaktuara në rregullore;
- ✓ respekton të drejtat e subjektit;
- ✓ merr në subjekt informacionet e nevojshme për të realizuar objektin e inspektimit;
- ✓ respekton hapat për plotësimin e dokumenteve standarde;
- ✓ respekton rregullat për marrjen e mostrave, nëse ka;
- ✓ plotëson korrekt rubrikat e dokumenteve standarde;
- ✓ përdor dhe merr fakte me foto, video dhe audio, për dokumentim në dosje;
- ✓ këshillon subjektin e inspektuar;
- ✓ respekton rregullat për llojin e vendimit të marrë për procedurën e inspektimit;

Të drejtat dhe detyrimet e subjektit të inspektimit

- ✓ Njohja me autorizimin;

- ✓ Identifikimi i inspektorëve;
- ✓ Marrja e informacionit;
- ✓ Paraqitja e mendimeve, komenteve, shpjegimeve, kontestimeve;
- ✓ Të kërkojë të njihet dhe t'i njoftohet procesverbali i inspektimit;
- ✓ Të paraqesë kontestimet e tij për vlerësimin e provave të administruara, për rezultatet e hetimit dhe për vendimin që synohet të merret nga organi publik.

Të drejtat dhe detyrat e inspektorit

- ✓ bashkëpunimi dhe mospengimi;
- ✓ paraqitja e informacioneve, dokumenteve, shpjegimeve;
- ✓ të ndalojë kryerjen e plotë apo të pjesshme të veprimtarisë, nëse kjo është e domosdoshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së inspektimit dhe kur kërkohet nga inspektori me shkrim në procesverbalin e inspektimit;
- ✓ të sigurojë një vend të përshtatshëm për punën e inspektorit, nëse inspektimi kryhet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë;
- ✓ të lejojë dhe të mundësojë marrjen e dëshmive nga punëmarrësit e tij, nëse kjo kërkohet nga inspektori.

Masat urgjente

- ✓ Nevoja për mbrojtjen e interesit publik:
 - Urgjenca
 - Konstatimi i një rreziku, si pasojë e një shkeljeje apo dyshimi për një të tillë
 - Dëm i menjëhershëm
 - Dëm i pariparueshëm për interesin publik
 - Shkelje apo dyshim për shkelje të kërkesave ligjore

Masat Administrative

Dënim administrativ është çdo masë apo sanksion administrativ, pavarësisht nga emri i parashikuar nga ligji, që rregullon një funksion inspektimi:

- ✓ masa administrative kryesore
- ✓ masa administrative plotësuese

Ankimi dhe ekzekutimi i vendimit

- ✓ Ankimi administrativ kundër vendimit përfundimtar paraqitet dhe shqyrtohet pranë “organit epror” (trupa kolegjiale) të inspektoratit shtetëror përkatës.
- ✓ Trupa kolegjiale shqyrton ankimin brenda 15 ditëve nga data e depozitimit, por jo më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të procesverbalit dhe vendimit përfundimtar (Rregullorja për procedurën e inspektimeve).****Shqyrtimi i ankimimit detyrimisht në prani të subjektit ankimues!!**

- ✓ Vendimi i Trupës Kolegjiale është i formës së prerë dhe mund të ankimohet vetëm në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja e vendimit.

1. Inspektimi i naftës

Struktura përgjegjëse e inspektimit Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe nënprodukteve të tyre.

- ✓ Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për Përpunimin, Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar
- ✓ VKM nr.970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar;
- ✓ VKM nr.755, datë 12.11.2014, “Për përcaktimin e procedurave e të kushteve për dhënien e “licencës së përpunimit” për impiantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës”;
- ✓ VKM nr.19, datë 14.01.2015, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj”, i ndryshuar;
- ✓ VKM nr.411, datë 13.05.2015, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e përsëritjen e licencës”.

Përpunimi, Transporti dhe Tregtimi i Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre

Qëllimi

Ky modul synon aftësimin e inspektorit për kryerjen e procesit inspektues në përputhje me parimet dhe kërkesat ligjore në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Njohuritë që ofron ky modul

- ✓ Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre:
 - Rafineritë e naftës dhe impiantet e përpunimit
 - Naftësjellësit dhe gazsjellësit
 - Shoqëritë e tregimit me shumicë dhe Stacionet e shitjes së karburanteve
 - Njësitë e lëndëve djegëse

- ✓ Klasifikimi i naftës, gazit natyror dhe nënprodukteve e tyre
- ✓ Leja e koncesionit
- ✓ Leja e tregtimit
- ✓ Licenca e përpunimit

Tematikat kryesore që do të zhvillohen

- ✓ Subjektet që ushtrojnë veprimtari të përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre
- ✓ Procedura e dhënies së licencave të tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj
- ✓ Llojet e licencave të tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj
- ✓ Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë
- ✓ Kushtet për pajisjen me licencë të tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj
- ✓ Kushtet dhe procedurat për pajisjen me miratim paraprak me licencë koncesioni për Rafineri
- ✓ Procedurat për pajisjen me licencë koncesioni për rafineri, pas miratimit paraprak
- ✓ Procedurat për transferimin e licencës së koncesionit për rafineri
- ✓ Procedurat për përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri
- ✓ Procedurat dhe kushtet për dhënien e përsëritjen e licencës së koncesionit të naftësjellësve për importimin, eksportimin dhe transportimin e naftës bruto
- ✓ Procedurat dhe kushtet për dhënien e “licencës së përpunimit” për impiantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës
- ✓ Procedurat e trajtimit, të mbikëqyrjes dhe të kontrollit sasior, cilësor dhe fiskal të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj
- ✓ Inspektimi i respektimit të kërkesave ligjore dhe masat administrative për mosrespektimin e tyre


Përfituesit

Ky trajnim i shërben të gjithë inspektorëve në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial që kryejnë funksione inspektimi në zbatim të dispozitave ligjore të cituara.

Metodologjia

Prezantimi i objektivave dhe rezultateve të pritshme nga moduli i trajnimit. Leksion teorik i dispozitave ligjore në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit e të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre. Diskutime rreth rasteve praktike.

Kontrolli mbi personat juridikë, që ushtrojnë veprimtari të përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre



Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ka të drejtë dhe përgjegjësi për:

- ✓ Kontrollin e zbatimit të normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- ✓ Miratimin e kartave teknologjike të impianteve dhe instalimeve përkatëse;
- ✓ Kontrollin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në licencat përkatëse, që u janë dhënë personave juridikë, përfshirë edhe kushtet teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe ruajtjen e mjedisit;
- ✓ Garantimin e së drejtës për informim të publikut dhe/ose subjekteve të interesuara mbi rezultatet e analizave të kontrollit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në ligjin për të drejtën e informimit;
- ✓ Kontrollin e respektimit të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj;
- ✓ Kryerjen e analizave në laboratorët e akredituar, për sasi të naftës e nënprodukteve të saj, të prodhuara në vend, të importuara, para zhdoganimit, si dhe për kontrollin periodik të detyrueshëm të subjekteve që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- ✓ Kontrollin e cilësisë së nënprodukteve të naftës të konsumatorët e mëdhenj.

Licenca e tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj nga QKL

| <i>Dokumentet e kërkuara</i> | | <i>Llojet e licencave</i> |
|---|---|---|
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkesën e subjektit për t'u pajisur me "Licencë tregtimi"; 2. Ekstraktin historik dhe tregtar të regjistrimit tregtar; 3. Vërtetimin e pronësisë ose kontratën e qirasë për depozitat/magazinat; 4. Projektin teknologjik të depove dhe të linjave, të miratuar nga organet përkatëse; 5. Dokumentacioni që vërteton për depozitat dhe linjat përkatëse teknologjike; | <ol style="list-style-type: none"> 6. Certifikatën e kalibrimit të vëllimit të depove; 7. Vërtetimin për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike; 8. Vërtetimin e pronësisë ose kontratën e marrjes në përdorim për automjetet e transportit; 9. Certifikatën e miratimit për mjetet që transportojnë disa mallra të rrezikshme; 10. Leje mjedisi; 11. Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve tatimore. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Lloji "A": tregtimi me shumicë i naftës bruto e nënprodukteve të saj të kategorive 0, II, III, IV e V, me përjashtim të nënprodukteve që destinohen për furnizimin e mjeteve të fluturimit ajror 2. Lloji "B": tregtimi me shumicë i gazit të lëngshëm të naftës, kategoria I, përfshirë edhe mbushjen e bombolave me këtë nënprodukt; 3. Lloji "C": tregtimi me shumicë i karburanteve, kategoritë II/B e III/C, për mjetet e fluturimit. |

Licenca e tregtimit me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj nga Ministria/ Organet e qeverisjes vendore

| <i>Dokumentet e kërkuara</i> | | |
|---|---|---|
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Ekstraktin historik dhe tregtar të regjistrimit tregtar; 2. Projektin teknologjik të depove dhe të linjave, të miratuar nga organet përkatëse; 3. Dokumentacioni që vërteton se stacioni i shitjes së karburantit është ndërtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi; 4. Vërtetimin për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike; | <ol style="list-style-type: none"> 5. Certifikatën e kalibrimit të rezervuarëve, të vendosur në stacion, dhe të matjes së aparateve të shitjes; 6. Lejen e mjedisit; 7. Autorizimin hyrje-dalje në rrugë; 8. Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve vendore; 9. Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve tatimore. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera. 2. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera. |

“Licenca e Përpunimit” për impiantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës

| <i>Dokumentet e kërkuara</i> | |
|--|---|
| 1. Kërkesa nga subjektet aplikuese; | 10. Skemën e funksionimit të impiantit të miratuar; |
| 2. Ekstraktin historik dhe tregtar të regjistrit tregtar; | 11. Kontratën e punësimit të drejtuesit teknik; |
| 3. Dokumentin që vërteton se subjekti nuk është në proces falimentimi; | 12. Dokumente në formën e një letre komforti, marrëveshjeje paraprake kreditimi; |
| 4. Projektin teknologjik që do të zbatohet për ndërtimin e impiantit të përpunimit dhe ambienteve të depozitimit dhe/ose magazinimit; | 13. Dokumentin që vërteton se subjekti aplikues nuk është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë; |
| 5. Kartën teknologjike me parametrat e punës, lëndët e para dhe produktet përfundimtare të përfituara; | 14. Dokumentin që vërteton se përfaqësuesi i subjektit aplikues nuk ndodhet në ndjekje penale; |
| 6. Studimin paraprak të fizibilitetit; | 15. Dokumentin që vërteton se subjekti aplikues i ka plotësuar detyrimet fiskale; |
| 7. Lejen e mjedisit të veprimtarisë; | 16. Dokumentin që vërteton se subjekti aplikues i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore; |
| 8. Dokumentet me të dhënat e nevojshme për vendin e ushtrimit të veprimtarisë, si skemë-ideja e genplani, dhe dokumente që provojnë raportin me truallin | 17. Të dhëna për kapacitetet depozituese në projektin e ndërtimit të impiantit të përpunimit. |
| 9. Dokumentin që vërteton se vendi i para-shikuar për ndërtimin e impiantit të përpunimit; | |

Transferimi i “Licencës së përpunimit” bëhet vetëm pas miratimit të ministrisë, sipas rregullave të veçanta të miratuara nga ministri përgjegjës për hidrokarburet dhe me kusht që personi juridik, tek i cili transferohet “Licenca e përpunimit”, duhet të plotësojë aftësitë e nevojshme teknike dhe financiare, sipas dokumenteve të kërkuara.

Dhënia e “Licencës së përpunimit” të nënprodukteve e naftës bëhet kundrejt pagesës nga subjekti aplikues të tarifës prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, ndërsa rinovimi i “Licencës së përpunimit” bëhet kundrejt pagesës së tarifës 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

Licenca e koncesionit për rafineri

| <i>Dokumentet bazë për pajisjen me miratim paraprak:</i> | |
|---|---|
| 1. Ekstraktin e regjistrit tregtar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit; | 9. Dokumente në formën e një letre interesi, marrëveshjeje paraprake kreditimi; |

| <i>Dokumentet për pajisjen me licencë koncesioni për rafineri</i> |
|--|
| Ridorëzimi i dokumenteve bazë të pajisjes me miratim paraprak + |
| 1. Lejen e mjedisit 2. Lejen e zhvillimit |

| | | |
|---|---|---|
| <p>2. Skemën dhe projektin teknologjik për secilin impiant;</p> <p>3. Skemën e furnizimit me lëndë të parë dhe atyre ndihmëse;</p> <p>4. Studimin paraprak të fizibilitetit;</p> <p>5. Deklaratën mjedisore në përfundim të procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis;</p> <p>6. Genplanin e vendit ku parashikohet të ndërtohet rafineria;</p> <p>7. Dokumentin që vërteton se përdorimi i tokës ku do të ndërtohet rafineria është parashikuar për ndërtimin e objekteve të kësaj natyre;</p> <p>8. Dokumentacionin që vërteton përvojën në fushën e ndërtimit dhe vënies në funksionim të rafinerive;</p> | <p>10. Deklarimin për vlerën e bonusit të nënshkrimit të licencës;</p> <p>11. Vlerën e bonusit vjetor të trajnimit;</p> <p>12. Dokumentin që vërteton se përfaqësuesi i personit juridik nuk ndodhet në ndjekje penale;</p> <p>13. Dokumentin që vërteton se personi juridik i ka plotësuar detyrimet fiskale;</p> <p>14. Dokumentin që vërteton se personi juridik i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore;</p> <p>15. Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesave të energjisë elektrike.</p> | <p>3. Projektin e detajuar teknologjik për ndërtimin e rafinerisë dhe të ambienteve të infrastrukturës</p> <p>4. Kartën teknologjike me parametrat e punës dhe produktet përfundimtare të përfituara</p> <p>5. Kontratën e punësimit të drejtuesit teknik</p> <p><i>Dhënia e licencës së koncesionit për rafineri për ndërtimin e rafinerisë për përpunimin e naftës bruto dhe funksionimin e saj bëhet sipas klasifikimit të mëposhtëm, kundrejt një pagese prej:</i></p> <p>- 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh për rafineri me kapacitet përpunimi deri në 100 000 tonë;</p> <p>- 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh për rafineri me kapacitet përpunimi nga 100 000 tonë deri në 200 000 tonë;</p> <p>- 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh për rafineri me kapacitet përpunimi nga 200 000 tonë deri në 300 000 tonë;</p> <p>- 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh për rafineri me kapacitet përpunimi mbi 300 000 tonë.</p> |
|---|---|---|

Licenca e koncesionit të naftësjellësve për importimin, eksportimin dhe transportimin e naftës bruto pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Dokumentet bazë për pajisjen me miratim paraprak:

Dokumentet për pajisjen me licencë koncesioni të naftësjellësve

| | | |
|--|--|---|
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Ekstrakti i regjistrimit tregtar; 2. Përmbledhje me treguesit kryesorë teknikë, teknologjikë & financiarë të projektit të propozuar; 3. Studim paraprak të fizibilitetit; 4. Deklaratën mjedisore pas VNM; 5. Genplanin e vendit ku parashikohet të ndërtohet naftësjellësi; 6. Oponencën paraprake; 7. Dokumentacionin që vërteton përvojën e subjektit; 8. Dokumentin që vërteton se përdorimi i tokës; 9. Bilancin e tri viteve të fundit të veprimtarisë, të certifikuar; 10. Dokumente në formën e një letre interesi; 11. Deklarimin për vlerën e bonusit të nënshkrimit të licencës; | <ol style="list-style-type: none"> 12. Vlerën e bonusit vjetor të trajnimit që ofron personi juridik; 13. Dokumentin që vërteton se personi juridik nuk është dënuar me vendim të formës së prerë; 14. Dokumentin që vërteton se përfaqësuesi i personit juridik nuk ndodhet në ndjekje penale; 15. Dokumentin që vërteton se personi juridik i ka plotësuar detyrimet fiskale kombëtare dhe vendore; 16. Dokumentin që vërteton se personi juridik i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore; 17. Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesave të energjisë elektrike. | <p>Ridorëzimi i dokumenteve bazë të pajisjes me miratim paraprak</p> <p>+</p> <ol style="list-style-type: none"> 6. Lejen e mjedisit të tipit A apo B 7. Lejen e zhvillimit 8. Skemën kryesore me treguesit teknikë dhe ekonomikë të projektit 9. Skemën tërësore të naftësjellësit 10. Kontratën e punësimit të drejtuesit teknik <p><i>Dhënia e licencës së koncesionit për naftësjellës, për ndërtimin e naftësjellësit, për transportimin, importimin dhe eksportimin e naftës bruto, bëhet kundrejt pagesës së tarifës prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh nga personi juridik</i></p> |
|--|--|---|

Moduli 2

Prodhimi, transportimi dhe tregtimi i biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport

- ✓ Ligji nr. 9876, datë 14.02.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e Biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, i ndryshuar
- ✓ VKM nr. 429, datë 26.06.2019, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”
- ✓ VKM nr.147, datë 21.03.2007, “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel”
- ✓ VKM nr. 114, datë 27.01.2009, “Për marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë dhe të veprimtarive në instalimet e impiantet, që shërbejnë për depozitimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”
- ✓ Udhëzim nr. 913, datë 27.12.2018, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me karburant për konsum të anijeve në porte dhe në rada (kodi vii.5.7)”

Qëllimi

Ky modul synon aftësimin e inspektorit për kryerjen e procesit inspektues në përputhje me parimet dhe kërkesat ligjore në fushën e prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për zëvendësimin e nënprodukteve të naftës për sektorin e transportit.

Njohuritë që ofron ky modul fokusohen në

- ✓ Njësitë e prodhimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme
- ✓ Përgatitja për tregtim e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme
- ✓ Organizimi i tregut të biokarburanteve dhe i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme
- ✓ Leja e prodhimit
- ✓ Regjimi tatimor
- ✓ Cilësia e lëndëve djegëse

Tematikat kryesore që do të zhvillohen

- ✓ Organizimi i veprimtarive të prodhimit dhe të tregtimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme;
- ✓ Kriteret e zbatueshme lidhur me cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel;
- ✓ Llojet e lëndëve djegëse të lëngëta dhe vlerat kufi të përmbajtjes së squfurit në to;
- ✓ Treguesit fiziko-kimikë të lëndës djegëse, të cilat duhet të përmbushen përpara tregtimit të tyre;
- ✓ Kushtet e përdorimit të lëndëve djegëse të lëngëta nga anijet në portet, ujërat territoriale të Shqipërisë, zonat ekskluzive ekonomike dhe zonat e kontrollit të shkarkimit të oksideve të squfurit në ajër;
- ✓ Mënyrën e përcaktimit dhe të monitorimit të treguesve tekniko-cilësorë të lëndës djegëse;
- ✓ Metodat për reduktimin e shkarkimeve të lëndëve, ndotësve në ajër, dhe raportimin e përputhshmërisë me vlerat kufi të përmbajtjes së ndotësve;
- ✓ Kontrolli i standardeve të cilësisë së lëndëve djegëse të lëngëta në tregun e naftës dhe të nënprodukteve të saj;
- ✓ Procedura e dhënies së licencave për ushtrimin e veprim-tarisë së furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në Rada.


Cilësitë që duhet të përmbushin lëndët djegëse që tregtohen nga subjektet

- ✓ Tregtimi i benzinës pa plumb
- ✓ Vetëm tregtimi i lëndës djegëse diesel për përdorim në automjetet rrugore dhe gjeneratorët
- ✓ Përmbajtja e squfurit në lëndën djegëse, për motorët diezel, nuk lejohet të kalojë 10 mg/kg
- ✓ Pikat e shitjes duhet të reklamojnë, qartë dhe dukshëm, për blerësit:
 - përputhjen e parametrave mjedisorë të benzinës me standardin shqiptar S SH EN228, në fuqi, ose me standardet e tjera, të barasvlershme me të
 - përmbajtjen maksimale, të lejueshme të squfurit, si dhe përputhjen e parametrave mjedisorë të diezELIT me standardin shqiptar S SH EN 590 ose standardet e tjera, të barasvlershme me të.

Kontrolli standardeve të cilësisë së lëndëve djegëse në anijet detare nga ISHTI konsiston në:

- ✓ Kontrollin e regjistrave (logbooks) me veprimet e ndërmarra në përpjekje për të arritur përputhshmërinë dhe notën e lëshuar nga furnizuesi për të paktën 10% të numrit total të anijeve që lundruan në /nga portet shqiptare të hapura për trafikun ndërkombëtar gjatë 1 viti
- ✓ Kontrollin e dokumentacionit për prokurimin e lëndëve djegëse të lëngëta, analizën e mostrave të vulosura të lëndës djegëse që digjet në anije ose marrjen e mostrave të karburantit për analizë në një objekt lundruar (notë e lëshuar nga furnizuesi)

- ✓ Kontrollin e cilësisë së lëndëve djegëse të lëngëta detare për përmbajtjen e squfurit, për të paktën 30% të anijeve nga 10% e numrit mesatar të anijeve që lundruan në/nga portet shqiptare të hapura për trafikun ndërkombëtar në tri vitet e fundit;
- ✓ Kontrollin e cilësisë së lëndëve djegëse të lëngëta detare edhe gjatë shpërndarjes, nëse furnizuesi i karburantit ka furnizuar lëndë djegëse së paku tre herë gjatë vitit kalendarik të kaluar, cilësia e të cilave nuk është në përputhje me notën e lëshuar.



2. Inspektimi i gazit

- ✓ Ligji nr.102, datë 23.9.2015 "Për sektorin e gazit natyror"
- ✓ VKM nr.573, datë 03.10.2018 "Për miratimin e rregullave dhe të procedurave në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse në sektorin e gazit natyror të Ministrisë përgjegjëse për energjinë"

Struktura përgjegjëse e inspektimit

Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe nënprodukteve të tyre

| <i>Dokumentet për pajisjen me licence lloji "A":</i> | | <i>Dokumentet për pajisjen me licence lloji "B":</i> |
|---|--|---|
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkesa e subjektit për t'u pajisur me licencë 2. Formularin e autodeklarimit 3. Ekstraktin historik dhe tregtar të regjistrit tregtar 4. Licencë të kategorisë VIII.1.A për tregtimin me shumicë të naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio, si dhe lëndëve djegëse 5. Kontratë punësimi me një drejtues teknik të licencuar 6. Dokumentacion që provon pronësinë ose kontratën e qirasë për 5 (pesë) automjete tokësore tip autobot për furnizimin e anijeve në kalatë (leja e qarkullimit; certifikata e kontrollit të fundit teknik; certifikatën e miratimit ADR të mjetit) 7. Vërtetimin e pronësisë ose kontratën e qirasë për depozitat | <ol style="list-style-type: none"> 8. Projektin teknologjik të depove dhe të linjat përkatëse teknologjike, 9. Certifikatën e përdorimit 10. Certifikatën e kalibrimit të vëllimit të depove 11. Policë Sigurimi me vlerë primi jo më pak se 1.000.000 euro për shpërblimin ndaj dëmeve që mund t'u shkaktohen të tretëve 12. Plan Emergjence për reagimin ndaj ndotjes detare 13. Kontratë shërbimi me operatorë ekonomik që ofrojnë shërbimin për reagimin ndaj ndotjes detare ose deklaratë që ka në pronësi pajisje reaguese 14. Vërtetimin për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike | <p>Dokumentet për pajisjen me licence lloji "A"</p> <p style="text-align: center;">+</p> <p>Dokumentacion që provon pronësinë ose kontratën e qirasë të një mjeti lundrues tanker me kapacitet transportues mbi 100 DËT:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokument që vërteton pronësinë e mjetit lundrues 2. Dokument nga shoqëria klasifikuese që provon se kapaciteti transportues i mjetit lundrues të jetë mbi 100 DËT 3. policë sigurimi për shpërblimin ndaj dëmeve që mund të shkaktohen të tretëve nga anija 4. policë sigurimi në zbatim të Konventës Ndërkombëtare për Heqjen e Anijeve të Mbytura (ËRC 2007) 5. certifikatat e trajnimit të ekuipazhit për familjarizimin me anijen tanker, të lëshuara nga administrata detare në zbatim të Konventës STCË, rregulli V.1.1, seksioni V.1.1.1 ose V.1.1.2 |

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

- ✓ Rregullat dhe procedurat për ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse në sektorin e gazit natyror;
- ✓ Mbikëqyrja dhe inspektimi nga ISHTI në sektorin e gazit sipas ligjit nr. 102/2015 dhe VKM nr. 573, datë 03.10.2018;
- ✓ Standardet minimale të sigurisë së furnizimit me gaz natyror, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm;
- ✓ Rregullat teknike dhe të sigurisë në sektorin e gazit natyror;
- ✓ Detyrimet e subjekteve që ndërtojnë e shfrytëzojnë infrastrukturën në sektorin e gazit natyror dhe janë operatorë në transmetimin, shpërndarjen e depozitimin nëntokësor të gazit natyror, si dhe në терминаlet e gazit natyror të lëngëzuar;
- ✓ Kundërvajtjet administrative.

Moduli 3

3. Inspektimi i pajisjeve nën presion

- ✓ Ligji nr. 32/2016, datë 24.03.2016, “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Instalimeve nën Presion”;
- ✓ VKM nr. 212, datë 16.3.2016, “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”;
- ✓ VKM nr. 1062, datë. 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”;
- ✓ VKM nr. 1065, datë. 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik “Enët e thjeshta nën presion” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”;
- ✓ VKM nr. 430, datë 26.06.2019, “Për miratimin e rregullit teknik për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve të transportueshme nën presion”;
- ✓ Urdhër nr. 128, date 08.04.2016, “Për miratimin e procedurave për kontrollin teknik të vlerësimit të konformitetit të bombolave të GLN”.

Struktura përgjegjëse e inspektimit

Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike dhe makinerive ngritëse

Objektivi

Njohja me kuadrin ligjor mbi:

- ✓ Kërkesat thelbësore të sigurisë për pajisjet, instalimet dhe rrjetet elektrike;
- ✓ Kontrolli teknik fillestar dhe periodik i pajisjeve dhe instalimet elektrike;
- ✓ Detyrimet e punëdhënësve dhe informimi i punëmarrësve;
- ✓ Rregulla mbi sigurinë e pajisjeve elektrike dhe lëvizjen e lirë të tyre në tregun shqiptar;
- ✓ Rregulla për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente (atmosfera) potencialisht shpërthyes;
- ✓ Lista e standardeve të harmonizuara shqiptare për makineritë;
- ✓ Siguria e produkteve mekanike-elektrike:

Faza nga prodhimi deri para shpërndarjes së produkteve;

- ✓ Deklarata EC e konformitetit;
- ✓ Markimi CE i konformitetit;
- ✓ Detyrimet e prodhuesit, importuesit dhe shpërndarësi, të produktit/instalimit.

Detyra funksionale

- ✓ Ndjek zbatimin e detyrimit të subjekteve, që pajisjet/instalimet nën presion, t'i nënshtrohen vlerësimit të konformitetit nga një organ i miratuar/notifikuar;
- ✓ Kryen inspektime tek operatorët ekonomikë privatë ose entet publike që ushtrojnë veprimtari me pajisje/instalime nën presion, ku vlerëson nëse:
 - ushtrimi i aktivitetit që shfrytëzon pajisjet/instalimet nën presion, kryhet në përputhje me kërkesat e këtij ligji;
 - miratimi për zhvillimin e aktivitetit që shfrytëzon pajisjet/instalimet nën presion është marrë në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 - është përgatitur dokumentacioni teknik i nevojshëm për vendosjen e pajisjeve dhe instalimeve nën presion;
 - instalimi dhe testimi i pajisjeve/instalimeve nën presion është bërë në përputhje me legjislacionin dhe aktet teknike në fuqi;
 - pajisja/instalimi nën presion është mirëmbajtur rregullisht gjatë funksionimit të saj dhe nëse ajo është e kontrolluar dhe testuar në përputhje me rregullat teknike në fuqi;
 - personat që përdorin pajisjet/instalimet nën presion dhe personat që punojnë në mirëmbajtjen e tyre plotësojnë kushtet e përcaktuara për këto veprimtari;
- ✓ Mban evidenca të historikut të inspektimeve teknike, avarive të ndodhura, regjistrin të pajisjeve/instalimeve nën presion të përdorura nga subjektet përkatëse.
- ✓ Marrjen e masave administrative me gjobë dhe për raste shkeljesh të rënda të rregulloreve, me pasoja për jetën e njerëzve, kërkon ndjekje penale.
- ✓ Për mbikëqyrjen e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit shkëmben informacion me strukturat përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut dhe të mbrojtjes së Konsumatorit. Rezultatet e mbikëqyrjes së tregut dhe të mbrojtjes së konsumatorit i paraqiten Kryeinspektorit.

Moduli 4

- ✓ Ligji nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, i ndryshuar; Legjislacioni dytësor;
- ✓ VKM nr. 1061, datë 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”;

- ✓ VKM nr.1066, datë 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në Ambiente (atmosfera) potencialisht shpërthyesë” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”;
- ✓ VKM nr. 1060, datë 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik “Për makineritë” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”;
- ✓ Ligji nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 10480, datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”;
- ✓ Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008, “Për Mbrojtjen e Konsumatorit”.

Struktura përgjegjëse e inspektimit

Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike dhe makinerive ngritëse

Objektivi i modulit

Njohja me kuadrin ligjor mbi:

- ✓ Kërkesat thelbësore të sigurisë për pajisjet, instalimet dhe rrjetet elektrike;
- ✓ Kontrolli teknik fillestar dhe periodik i pajisjeve dhe instalimet elektrike;
- ✓ Detyrimet e punëdhënësve dhe informimi i punëmarrësve;
- ✓ Rregulla mbi sigurinë e pajisjeve elektrike dhe lëvizjen e lirë të tyre në tregun shqiptar;
- ✓ Rregulla për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente (atmosfera) potencialisht shpërthyesë;
- ✓ Lista e standardeve të harmonizuara shqiptare për makineritë;
- ✓ Siguria e produkteve mekanike-elektrike: Faza nga prodhimi deri para shpërndarjes së produkteve;
- ✓ Deklarata EC e konformitetit;
- ✓ Markimi CE i konformitetit;
- ✓ Detyrimet e prodhuesit, importuesit dhe shpërndarësi, të produktit/instalimit



Inspektorati Qendror

Tiranë, 2021

Adresa: Rruga “Frosina Plaku”, Nr. 58, Godina e Observatorit Kati 0, Tiranë. Tel: 042 229765.